



SOT NË PRISHTINË MBAHET 'MARSHI PËR LIRI', PRITET PJESËMARRJE MASIVE NGA E GJITHË KOSOVA

FAQE 7



Sot (e shtunë) në Prishtinë do të mbahet "Marshi për Liri", i organizuar nga platforma "Liria ka Emër", me thirrjen që qytetarët nga të gjitha

komunat e Kosovës t'i bashkohen marshit në përkrahje të krerëve të UÇK-së. Marshi do të nisë në orën 14:00 në Sheshin "Skenderbeu".

Organizatorët kanë njoftuar se nga qytete dhe vendbanime të shumta të Kosovës do të ketë autobusë të organizuar drejt Prishtinës

VETËVENDOSJA VAZHDON BLLOKADËN, KUVENDI NUK KONSTITUOHET

F. 3



AKTGJYKIM LIRUES PËR KRERËT E UÇK-së, DREJTËSI PËR KOSOVËN

F. 5

Arsim BAJRAMI



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SPORT



DUKAGJINI VAZHDON SERINË POZITIVE, MPOSHT MALISHEVËN DHE NGJITET NË VENDIN E DYTË

F. 10

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

NGA AL-KAIDA TE ‘UJQIT E VETMUAR’ DHE IA: SI NDRYSHOI TERRORIZMI PAS 11 SHTATORIT?

UASHINGTON, 11 SHTATOR - Farhad N. ishte vetëm disa muajsh kur, më 11 shtator 2001, terroristët e Al-Kaidës rrëmbyen avionë pasagjerësh dhe i përplasën dy prej tyre në kullat binjake të Qendrës Botërore të Tregtisë në Nju-Jork.

Sulmet në Shtetet e Bashkuara vranë mijëra njerëz. Njëzet e pesë vjet më vonë ai u dënua me burgim të përjetshëm pasi përplasi një veturë Mini Cooper për një turmë njerëzish në Munih, duke vrarë dy persona dhe plagosur dhjetëra të tjerë.

Historia e 25-vjeçarit afgan tregon se sa shumë ka ndryshuar kërcënimi terrorist që nga 11 Shtatori, e bashkë me të edhe mënyra se si luftohet terrorizmi.

Sulmet e 11 Shtatorit u planifikuan nga Al-Kaida - grup i udhëhequr nga milioneri saudit Osama bin Laden, dhe i strehuar nga regjimi taliban në Afganistan. Talibanët u rrëzuan më pas nga pushteti.

Farhad N., mbiemri i të cilit u shkurtua në përputhje me rregullat gjermane për privatësinë, u rrit në një Afganistan ku forcat ndërkombëtare të udhëhequra nga ShBA-ja luftuan për 20 vjet kundër talibanëve.

Më vonë ai ishte në mesin e qindra mijëra afganëve që u larguan nga vendi në kërkim të paqes dhe një jete më të mirë në Evropë. Por, atje u radikalizua nga propaganda në internet, e publikuar nga imamë në vendlindjen e tij. Ai nuk kishte lidhje me ndonjë grup të caktuar dhe, sipas të dhënave, duket se veprimi tërësisht me iniciativën e tij.

“Dikur do t’i quanim aktorë të vetmuar apo ‘ujq të vetmuar’. Kjo është e ardhmja”, thotë për Radion Evropa e Lirë një ish-diplomat amerikan me dekada përvojë në luftën kundër terrorizmit. “Askush nuk ka më nevojë të jetë pjesë e një grupi... Mund të frymëzohet nga një grup, mund të frymëzohet

nga disa grupe”, thotë ish-diplomati i cili kërkon të mbetet anonim. Sipas tij, përparimet në inteligjencën artificiale po e përshpejtojnë edhe më shumë këtë ndryshim në natyrën e kërcënimeve terroriste.

REL-i bisedoi me disa ekspertë për mënyrën se si teknologjitë që nuk ekzistonin 25 vjet më parë - përfshirë dronët, inteligjencën artificiale dhe mediet sociale - janë duke krijuar një mjedis krejtësisht të ri dhe më të rrezikshëm. “Po shohim një prani shumë më të madhe në internet. Po shohim përdorim shumë më të madh të influencuesve... Përveç aktorëve tradicionalë që jemi mësuar t’i shohim në skenën terroriste, tani kemi edhe individë që veprojnë vetëm, të ndikuar nga të tjerët”, thotë për Radion Evropa e Lirë gjenerali amerikan në pension, Joseph Votel.

Votel udhëhoqi një sulm me parashutistë të forcave amerikane kundër pozicioneve talibane në Kandahar, në tetor të vitit 2001 - vetëm disa javë pas sulmeve të 11 Shtatorit në Nju-Jork dhe Uashington. Më pas ai luajti rol të rëndësishëm në atë që u quajt “Lufta kundër Terrorit”, duke shërbyer edhe në Irak dhe duke komanduar operacione kundër militantëve të Shtetit Islamik (IS).

“Këto organizata terroriste kanë mbijetuar. Ato kanë vazhduar të përshtaten sa kanë mundur... janë bërë më të sofistikuar”, thotë ai. “Mjedisi është shumë më kompleks tani për ekspertët e sigurisë”, thekson Votel.

“Terroristët e vjetër”

Historia e Al-Kaidës pas 11 Shtatorit është edhe histori e degëve të saj në pjesë të ndryshme të botës. Grupe si Al-Shabaab në Somali dhe Jama’at Nusrat al-Islam wal-Muslimin (JNIM) në rajonin e Sahelit, në Afrikën Perëndimore, u lidhën me Al-Kaidën, duke ndërthurur synimet



e tyre lokale me ambiciet e saj për sulme në nivel global.

Kjo strukturë e decentralizuar i mundësoi Al-Kaidës të mbijetonte edhe pasi forcat amerikane goditën rëndë udhëheqjen e saj dhe i shkatërruan strehët e sigurta në Afganistan në muajt pas 11 Shtatorit.

Strategjia e re amerikane kundër terrorizmit, e publikuar në maj, e vendos Al-Kaidën dhe “degën e saj më agresive, Al-Kaidën në Gadishullin Arabik (AQAP)”, në krye të listës së atyre që i quan “terroristë islamistë të trashëguar”. Një raport i Kombeve të Bashkuara, i publikuar muajin e kaluar, e përshkroi AQAP-in si “pararojën” e lëvizjes globale të Al-Kaidës.

Studimet në vitet e fundit kanë treguar se degët e Al-Kaidës bashkëpunojnë në financim dhe trajnim. Për shembull, monitoruesit e OKB-së raportuan vitin e kaluar për një pagesë të vetme prej 50 milionë dollarësh si shpërblim për JNIM-in, një pjesë e të cilit u nda me AQIM-in - Al-Kaidën në Magrebin Islamik - AQAP-in në Jemen dhe “udhëheqjen e lartë të Al-Kaidës në Azinë Jugore”.

Këto grupe po e shtojnë, gjithashtu, propagandën në internet. “Propaganda e Al-Kaidës në Jemen u rrit jashtëzakonisht pas tërheqjes nga Afganistani dhe ka vazhduar deri më sot. Ata kanë

publikuar më shumë sesa kam publikuar unë gjatë dy vjetëve të fundit”, thotë për Radion Evropa e Lirë, Sara Harmouch, eksperte e terrorizmit dhe bashkëpunëtore në Institutin Frontier Security dhe në Programin për Ekstremizmin në Universitetin George Washington. “Vetëm disa muaj më parë Al-Kaida në Jemen publikoi deklarata dhe video që nxisnin sulme nga ‘ujq të vetmuar’, duke u bërë thirrje individëve në Perëndim të kryenin sulme në territorin e ShBA-së dhe në Evropë”, thotë ajo.

“Po fluturojmë verbërisht?”

Në këtë mjedis që ndryshon me shpejtësi, shfaqet edhe një problem tjetër: dobësimi i kapaciteteve për luftimin e terrorizmit. “Po fluturojmë verbërisht. Gjatë një viti e gjysmë të fundit... kemi humbur njerëz dhe kemi humbur fonde”, thotë ish-diplomati amerikan, duke shtuar se situata aktuale gjeopolitike e ka bërë sfidën edhe më të madhe. “Për momentin jemi disi në syrin e stuhisë, mes pasojave të 7 tetorit [sulmit të udhëhequr nga Hamasi kundër Izraelit, më 2023] dhe luftës së vazhdueshme me Iranin”, thotë ai. “Kemi humbur shumë njerëz të zotë, që kishin përvojë nga terreni

dhe njohuri institucionale”, shton ish-diplomati.

Shqetësime të ngjashme ngritën edhe ekspertë të tjerë të njohur të luftës kundër terrorizmit gjatë një diskutimi online të Universitetit George Washington, më 2 shtator. Tom Sanderson, nga Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare (CSIS), foli për “zvogëlim të vëmendjes ndaj terrorizmit, të buxheteve dhe të personelit”, ndërsa Bruce Hoffman, nga Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë (CFR), foli për një “largim masiv” të stafit nga zyra për luftën kundër terrorizmit e Departamentit Amerikan të Shtetit, e cila u ristrukturua vitin e kaluar.

Shtëpia e Bardhë dhe Departamenti Amerikan i Shtetit nuk iu përgjigjën kërkesave për koment lidhur me çështjet e ngritura në këtë artikull.

Financimi për luftën kundër terrorizmit nisi të zvogëlohej pas një rishikimi në vitin 2018, ndërsa këto shkurtime janë përshpejtuar që nga viti 2025.

Strategjia amerikane kundër terrorizmit thotë se “Komuniteti i Inteligjencës nuk i ka shërbyer mirë vendit tonë, pasi ka mbetur i ngërthyer në mënyra të vjetra të vlerësimit të kërcënimeve”.

Jonathan Schroden, drejtues i kërkimeve në CNA, një tjetër institut me seli në Uashington, thotë për Radion Evropa e Lirë se vitet e fundit ka ndodhur një ndryshim i rëndësishëm në politikën amerikane. “Synimet tona kanë ndryshuar: nga mposhtja e plotë e këtyre grupeve, te menaxhimi efektiv i kërcënimit që ato paraqesin... duke e mbajtur atë larg territorit të Shteteve të Bashkuara”, thotë ai. “Mendoj se struktura që ShBA-ja ka tani, ka qenë - në masë të madhe - efektive në arritjen e këtij qëllimi, gjatë pesë apo shtatë vjetëve të fundit”, përfundon Schroden. (Rel)

Trumpi thotë se nuk është penduar për luftën me Iranin

UASHINGTON, 11 SHTATOR - Presidenti amerikan Donald Trump tha se nuk është penduar që ka hyrë në luftë me Iranin pavarësisht prej ndikimit të mundshëm të konfliktit në zgjedhjet e mesmandatit në nëntor në Shtetet e Bashkuara, duke shtuar se do të merrte sërish të njëjtin vendim. “Nuk besoj te fjala ‘pendesë’. Gjithmonë mund ta vini pak në dyshim veten”, tha Trumpi për “Fox News”, në një intervistë të transmetuar më 10 shtator. “Nëse do të më duhej ta bëja përsëri, do të bëja saktësisht atë që bëra”, shtoi udhëheqësi

amerikan.

Trumpi hodhi poshtë, po ashtu, sugjerimet se disa prej mbështetësve të tij ishin demoralizuar nga lufta, duke theksuar se ata ishin “shumë krenarë për faktin se nuk po e lejoj Iranin të ketë armë bërthamore”.

Ai përsëriti parashikimin e tij se konflikti do të përfundonte pas zgjedhjeve të mesmandatit në ShBA. “Përfundon menjëherë pas zgjedhjeve”, tha ai, një ditë pasi akuzoi Teheranin se po përpiqej të ndikonte në votimet në ShBA. Rritja e çmimeve të naftës dhe benzinës - rritje e lidhur me

konfliktin - është bërë problem për republikanët në prag të zgjedhjeve.

ShBA-ja dhe Izraeli nisën sulmet ajrore ndaj Iranit në fund të shkurtit. Në qershor, Teherani dhe Uashingtoni nënshkruan një memorandum mirëkuptimi që synonte t’u jepte fund armiqësisë, por marrëveshja dështoi.

Javët e fundit palët janë përfshirë në sulme reciproke, për të cilat vëzhguesit thonë se mund të rrezikojnë që ta përshkallëzojnë konfliktin dhe konflikti të kthehet në një luftë në shkallë të plotë.



KOSOVA NDERON VIKTIMAT E SULMEVE TË 11 SHTATORIT

EPOKA ERE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Krerët shtetërorë të Kosovës i kanë kujtuar dhe nderuar viktimat e 11 Shtatorit, duke bërë homazhe pranë memorialit “Kosova kujton”, në 25-vjetorin e sulmeve terroriste ndaj Shteteve të Bashkuara. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, pas homazheve, tha se para një çerek shekulli ShBA-ja u përball me sulmet më vdekjeprurëse dhe bota pësoi goditjen më të rëndë ndaj vlerave demokratike. “Kosova qëndron pranë ShBA-së jo vetëm pse ShBA-ja kurrë nuk

ndan kujtimin e saj edhe sot, duke nderuar viktimat dhe duke ruajtur po atë afërsi që u dëshmuar në ditët më të rënda për dy vendet tona. I përjetshëm qoftë kujtimi për viktimat e 11 Shtatorit”, tha Haxhiu.

Kryetari Bedri Hamza, i shoqëruar nga deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës, në 25-vjetorin e sulmit terrorist mbi kullat binjake në ShBA, kanë bërë homazhe te memoriali “Kosova kujton”, në nderim të viktimave të kësaj tragjedie. Kryetari Hamza tha se më 11 shtator 2001 mijëra jetë të pafajshme humbën në një nga tragjeditë më të rënda të



Shtatorit 2001, që mori jetën e rreth 3 000 njerëzve të pafajshëm, tronditi mbarë botën dhe mbeti në kujtesën e përbashkët si një nga aktet më të rënda të terrorizmit”, ka shkruar Abdixhiku.

Ai ka theksuar se sulmi nuk ishte vetëm një goditje ndaj Shteteve të Bashkuara, por edhe një sfidë ndaj vlerave

themelore të shoqërive demokratike, si liria, paqja dhe bashkëjetesa. “Sot përulemi me respekt të thellë para kujtimit të viktimave dhe shprehim solidaritetin tonë të plotë me familjet e tyre dhe me popullin amerikan. Dhimbja e tyre është pjesë e kujtesës sonë të përbashkët”, ka deklaruar ai, duke shtuar se lidhja e Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk është vetëm marrëdhënie mes dy vendeve; është një lidhje e ndërtuar mbi besim, vlera dhe një histori të përbashkët solidariteti.

Më 11 Shtator 2001 katër aeroplanë goditën në lokacione të ndryshme në ShBA, duke lënë të vrarë gati 3 000 persona. Nëntëmbëdhjetë anëtarë të grupit terrorist Al-Kaida rrëmbyen aeroplanë, duke përplasur dy prej tyre në Kullat Binjake në Nju-Jork, ndërkaq një aeroplan goditi Pentagonin, ndërkaq i katërti u rrëzua në një fushë në Pensilvani.

FSK-ja nderon viktimat e 11 shtatorit 2001

Në shenjë nderimi dhe përkujtimi të viktimave të sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Forca e Sigurisë së Kosovës ka ulur sot flamujt në gjysmështizë në të gjitha kazermat e FSK-së. Me këtë akt simbolik, FSK-ja përkujton viktimat e pafajshme të kësaj tragjedie dhe shpreh solidaritetin e saj me popullin amerikan, familjet e viktimave dhe të gjithë ata që humbën jetën duke u përballur me pasojat e sulmeve terroriste.

Populli i Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës qëndrojnë përherë në krah të popullit amerikan, miqve dhe partnerëve tanë strategjikë, duke ndarë dhimbjen në ditët e vështira dhe duke festuar së bashku në ditët e gëzimit. Miqësia dhe solidariteti ynë mbeten të palëkundura.

e ka braktisur Kosovën. Ne qëndrojmë dhe gjithmonë do të qëndrojmë me Amerikën sepse përkushtimi ynë ndaj lirisë dhe demokracisë dhe vendosmëria jonë për t'i mbrojtur këto vlera është e palëkundur”, tha Kurti. Ai kujtoi se para një viti kishte vizituar në Nju-Jork memorialin kushtuar sulmeve të 11 Shtatorit dhe tha se aty la një shënim të shkurtër: “Kujtesa jeton, liria fiton”.

Ndërkaq, ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, në fjalën e saj kujtoi përjetimet e 11 Shtatorit 2001, duke thënë se populli i Kosovës ishte solidarizuar me ShBA-në në atë ditë, teksa në mbarë vendin ishin vendosur flamuj amerikan e mbishkrime “Amerikë jemi me ty”.

Sulmi ndaj ShBA-së, sipas saj, në Kosovë nuk u përjetua si tragjedi e një shteti tjetër e të largët. “Sulmi u kuptua si sulm ndaj lirisë, demokracisë dhe dinjitetit njerëzor, vlera që kishin qenë edhe në themel të mbështetjes amerikane për Kosovën”, tha ajo.

Haxhiu tha se brezi i ri nuk e përjetoi atë ditë, prandaj ajo tha se, përveç nderimit të viktimave, duhet që atij t'i mësohet se çfarë ndodhi të martën e 11 Shtatorit të vitit 2001. “Kosova e ndjeu dhimbjen e saj atëherë dhe e



kohës sonë. “Sot jemi me miqtë tanë amerikanë, duke kujtuar viktimat, duke nderuar guximin e ekipeve të emergjencës dhe duke shprehur solidaritetin tonë me të gjithë ata që u prekën nga kjo tragjedi. Kosova e di mirë vlerën e miqësisë dhe mbështetjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. 25 vjet më pas jemi krah miqve tanë amerikanë në kujtim të viktimave dhe në nderim të sakrificës së tyre. Nuk harrojmë kurrë”, theksoi ai.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se sulmet e 11 Shtatorit 2001, ku humbën jetën rreth 3 mijë persona, tronditën mbarë botën dhe mbetën në kujtesën kolektive si një nga aktet më të rënda të terrorizmit. “Mëngjesi i 11





VETËVENDOSJA VAZHDON BLLOKADËN, KUVENDI NUK KONSTITUOHET

Ka dështuar sërish të premten përmbyllja e seancës konstituive e Kuvendit të Kosovës. Procesi sërish ka mbetur te zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit. Votimi për nënkryetar u vendos të bëhet veç e veç. Në votim, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ardian Gola, u zgjodh nënkryetar i Kuvendit, ndërsa kandidatja e PDK-së, Vlora Çitaku, nuk arriti t'i marrë votat e nevojshme për t'u zgjedhur nënkryetare, pasi deputetët e LV-së abstenuan. Pas këtij procesi, deputetët e PDK-së e lëshuan sallën, duke paralajmëruar se më nuk marrin pjesë në seancën konstituive

nuk voton persona "që duan ta çojnë vendin në zgjedhje". Arbërie Nagavci nga LV-ja tha se pret që PDK-ja ta bëjë propozimin e ri për postin e nënkryetarit, ndërsa për LDK-në tha se nuk e përkrahin të propozuarin e saj, Kujtim Shala. Por, PDK-ja nuk u rikthye në sallë.

Vazhdimi i seancës konstituive të premten paradite nisi me mos pajtime lidhur me formën e votimit të nënkryetarëve, por më pas me 71 vota për u vendos që për pesë nënkryetarët të zhvillohej votim i ndarë.

Ardian Gola i Lëvizjes Vetëvendosje mori 100 vota dhe u zgjodh në këtë post, por Vlora Çitaku arriti të marrë vetëm 44 vota, pasi deputetët e LV-së abstenuan. Pas kësaj, Haxhiu kërkoi që PDK-ja të bënte sërish propozim për postin e nënkryetarit, por përveç Mërgim Lushtakut, të gjithë deputetët e PDK-së u larguan nga salla plenare.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, pas ndërprerjes së seancës konstituive, si pasojë e mosvotimit nga Lëvizja Vetëvendosje të kandidatës së propozuar nga PDK-ja për nënkryetare të Kuvendit, Vlora

Çitaku, njoftoi se PDK-ja nuk do të marrë më pjesë në punimet e Kuvendit.

Hamza në një konferencë për medie paralajmëroi se PDK-ja do ta referojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese. "Prej sot PDK-ja nuk ka asnjë arsye të marrë pjesë në punimet e Kuvendit të Kosovës dhe do ta referojmë lëndën në Gjykatën Kushtetuese. Jemi të sigurt që afatet kanë përfunduar më 7 gusht", u shpreh ai.

Hamza i cilësoi veprimet e LV-së antishtetërore dhe në kundërshtim me interesin e qytetarëve. "PDK-ja ishte prezente në Kuvend me qëllim që Kuvendi të konstituohet dhe vendi të ketë institucione. Mirëpo partia shumicë, Lëvizja Vetëvendosje dhe Albin Kurti, nuk kanë ndër mend t'i japin vendit institucione. Vazhdojnë me veprimet e tyre të papërgjegjshme, joinstitucionale dhe joshitetërore, jo në dobi të qytetarëve të Kosovës, duke prodhuar drama, kriza dhe situata të panjohura, me qëllim që ta vazhdojnë bllokadën", theksoi ai, duke shtuar se Lëvizja Vetëvendosje vendosi që votimi për nënkryetarët të mos bëhej si pako, por individualisht. "Përkundër kësaj, deputetët e

Partisë Demokratike të Kosovës votuan pro kandidatit të Vetëvendosjes për nënkryetar të Kuvendit, Ardian Gola, duke dëshmuar vullnet politik për përmbylljen e procesit dhe funksionalizimin e institucionit më të lartë ligjvënës. Në anën tjetër, LV-ja e përdori procedurën e votimit individual, të propozuar nga vetë ajo, për të mos e votuar kandidaten e PDK-së për nënkryetare të Kuvendit, duke pamundësuar kështu përfundimin e seancës konstituive. PDK-ja vlerëson se zhvillimet e sotme dëshmuar edhe një herë se pengesa për konstituimin e Kuvendit qëndron te kalkulimet politike të Lëvizjes Vetëvendosje", tha Hamza.

Ai shtoi se Partia Demokratike e Kosovës do të vazhdojë ta mbrojë rendin kushtetues dhe funksionimin demokratik të institucioneve, ndërsa për situatën e krijuar do të kërkojë interpretim dhe zgjidhje nga Gjykata Kushtetuese. "Kuvendi nuk mund të mbahet peng nga skemat procedurale të një partie", u shpreh Hamza.

Anëtari i kryesisë së Aleancës, Daut Haradinaj, tha se shkeljet e vazhdueshme të Kushtetutës dhe ligjeve, politikat mesquine e mashtrimet publike dhe, së

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, e ka shtyrë për të dielën vazhdimin e seancës për konstituimin e legjislaturës së 11-të, mes mosmarrëveshjeve për votimin e nënkryetarëve, pasi partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e braktisën sallën. PDK-ja e kishte braktisur sallën të premten paradite pasi Lëvizja Vetëvendosje në pushtet nuk ia kishte votuar kandidaten për nënkryetare, Vlora Çitaku, dhe nuk u kthye në sallë kur seanca vazhdoi pasdite.

LDK-ja nuk pranoi ta propozojë kandidatin e saj, pasi Haxhiu e tejkaloj zgjedhjen e nënkryetarit nga PDK-ja, i cili ishte i dyti në radhë për t'u zgjedhur, sipas procedurës.

Gjatë vazhdimit të seancës konstituive paraditen e së premtes, Ardian Gola nga LV-ja u zgjodh në postin e nënkryetarit, por jo edhe e propozuara e PDK-së, Vlora Çitaku.

Deputetët e PDK-së e lëshuan sallën dhe thanë se nuk do të marrin pjesë më në seancë dhe do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

LV-ja tha se voton nga një kandidat nga PDK-ja dhe Lidhja Demokratike të Kosovës për postin e nënkryetarit, por tha se

RAMA: VETËVENDOSJA SABOTOI PASTRIMIN E PRISHTINËS, DËSHTOI THEMELIMI I NDËRMARRJES ‘PASTRIMI’

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, e ka akuzuar subjektin Vetëvendosje se ka penguar themelimin e ndërmarrjes komunale “Pastrimi”, duke e cilësuar këtë “sabotim të pastrimit të Prishtinës”. Në “Facebook”, Rama ka kritikuar asamblistët e

Vetëvendosjes për votën e tyre, duke pretenduar se vendimi i tyre ka pamundësuar krijimin e ndërmarrjes që do të merrej me pastrimin e qytetit. “Me votën tuaj e latë qytetin në bërlllog, lagjet ku jetoni vetë, rrugët ku ecin fëmijët tuaj, familjet tuaja. Krejt qytetarët e Prishtinës i lini në bërlllog”, ka shkruar Rama.

Ai ka kritikuar ashpër edhe qytetarët që, sipas tij, i kanë votuar përfaqësuesit e Vetëvendosjes në Asamblenë Komunale. “Mjerë ata qytetarë që ju kanë votu dhe ju kanë besu kur ju keni shitë pallavra se jeni këtu për të mirën e tyre!”, ka deklaruar Rama. Kryetari i Prishtinës ka thënë se

vendimi për të mos e mbështetur themelimin e ndërmarrjes komunale është i pakuptimtë pasi, sipas tij, pasojat e një vendimi të tillë prekin të gjithë qytetarët, përfshirë edhe banorët e lagjeve ku jetojnë asamblistët. “Mos me votu me u hek bërlllogu prej dyerve tona, prej

lagjeve tona, prej rrugëve ku ecin fëmijët tanë, e kalon secilin nivel të logjikës. Kjo i bjen me punu kundër vetëvetes!”, ka shkruar Rama. Në fund të reagimit ai i ka kritikuar ashpër përfaqësuesit e Vetëvendosjes, duke e mbyllur postimin me fjalët: “Marre! Seriozisht, jeni për studim!”.



Ambasadori britanik takon kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale, theksohet rëndësia e bashkëpunimit

Prishtinë, 11 shtator - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, ka zhvilluar takim me ambasadorin e Britanisë së Madhe, Jonathan Hargreaves.

Gjatë takimit Hargreaves dhe Isufaj diskutuan për çështjet aktuale në fushën e sundimit të ligjit. Ambasadori britanik e përgëzoi Prokurorinë Speciale për punën e saj dhe

riafirmoi mbështetjen dhe rëndësinë e vazhdimit të bashkëpunimit. Mbështetjen dhe rëndësinë e vazhdimit të bashkëpunimit, me autoritetet e Britanisë së Madhe, e theksoi edhe Isufaj.



fundmi, edhe shantazhet ndaj rregullave të demokracisë parlamentare dhe opozitës, janë dëshmi e mjaftueshme për ta kuptuar se çka po synon ky grup i njerëzve të arrijë.

“Albin Kurti e ka problem të madh Republikën e 17 shkurtit 2008, andaj po e sulmon dhe po synon ta shpërbëjë. Republika e Kosovës nuk është laborator eksperimental i kuzhinave të kuqe, as për ikjen e fshehjen tënde nga Marrëveshja e Ohrit dhe e Brukselit. Albin, Republika është mbi ty e secilin prej nesh. Mjaft me politika mesquine që e dëmtojnë shtetin. Mos e sill Kosovën në të panjohura, se të gjithë njihemi mes vete”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Sipas një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi duhet të konstituohet brenda 30 ditësh nga data e certifikimit të rezultatit zgjedhor. Ky afat ka

skaduar më 7 gusht, por LV-ja më pas kishte argumentuar se afati vlen nga data e nisjes së seancës konstituive - pra nga 6 gushti. Por, edhe ky 30-ditësh, sipas interpretimit të LV-së, tashmë ka kaluar.

LV-ja: Nuk japim votë për persona që duan ta çojnë vendin në zgjedhje

Pas ndërprerjes së seancës, Arbërie Nagavci nga Lëvizja Vetëvendosje tha se partia e saj nuk ka vota për kandidatë për nënkryetarë të Kuvendit, që synojnë “ta dërgojnë vendin në zgjedhje”. “LV-ja do të votojë një kandidat të PDK-së dhe LDK-së për nënkryetar, por nuk mund ta votojmë Vlorë Çitakun dhe nuk vazhdojmë tutje në këtë situatë që ta konstituojmë Kuvendin. S’mund të japim votë për dikë që synon të na dërgojë në zgjedhje.

Pra, LV e voton një deputet nga radhët e PDK-së, se cili është ai deputet, duhet PDK të vazhdojë me propozime apo marrëveshje”, tha ajo. Sipas Nagavcit, seanca do të vazhdojë sot dhe partia e saj është e gatshme ta votojë edhe qeverinë dhe presidentin po sot. “Jemi të gatshëm që sot të vazhdojmë me votimin e qeverisë dhe presidentit dhe nuk mund të garantojmë që 53 votat tona të jepen dhe më pas vendi të çohet në zgjedhje”, tha Nagavci. Ndërkaq, Jehona Lushaku nga Lidhja Demokratike e Kosovës sqaroi se as për kandidatin e partisë për nënkryetar, Kujtim Shala, nuk ka përkrahje nga LV-ja.

“Shkuam me votim individual, sepse s’kishte përkrahje nga LV për propozimet tona”, tha Lushaku. Ajo shtoi se partia është e hapur për dialog për themelimin e institucioneve. “Ne

do t’i përdorim të gjitha format e propozimit dhe votimit. Do të vendosin deputetët e Kuvendit. Të shohim se a do të ketë përkrahje”, tha ajo. Bekim Sejdiu është propozuar për postin e presidentit nga LV-ja e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, dhe LDK-ja e udhëhequr nga Lumir Abdixhiku. Por, gjashtë deputetë - nga 18 sa ka LDK-ja në këtë legjislaturë - kanë thënë se nuk kanë votë për të. Në mesin e tyre është edhe Kujtim Shala, i propozuar për nënkryetar Kuvendi.

PDK-ja dhe LDK-ja, por edhe Lista Serbe, pas seancës të së mërkurës e akuzuan LV-në për zvarritje të procesit të krijimit të institucioneve të reja. Aleanca, ndërkaq, nuk mori pjesë fare, duke argumentuar se janë tejkaluar afatet kushtetuese për konstituimin e Kuvendit. Kuvendi konsiderohet i konstituuar vetëm pasi të

zgjidhen edhe pesë nënkryetarët. Me konstituimin e Kuvendit do të hapej rruga për formimin e Qeverisë së re të Kosovës dhe zgjedhjen e presidentit.

LV-ja, së bashku me partitë e komuniteteve joserbe, kanë vota të mjaftueshme për të zgjedhur një ekzekutiv të ri. Megjithatë, 53 votat e LV-së, dhe 12 - ashtu siç ka deklaruar Abdixhiku - të LDK-së, si dhe ato të pakicave joserbe, janë të pamjaftueshme për të zgjedhur një president të ri.

Për zgjedhjen e presidentit nevojitet prania e 80 deputetëve në Kuvendin me 120 vende që votimi për presidentin e Kosovës të jetë i vlefshëm.

Nëse deputetët s’arrijnë ta zgjedhin kreun e ri të shtetit, qytetarët do t’u drejtohen sërish kutive të votimit. Ato do të ishin zgjedhjet e katërta parlamentare dhe të dytat për shkak të moskonsensusit për presidentin, që nga shkurti i vitit 2025.

AKTGJYKIM LIRUES PËR KRERËT E UÇK-së, DREJTËSI PËR KOSOVËN



Arsim BAJRAMI

Tani kur kanë mbetur vetëm pak ditë e orë deri në shpalljen e aktgjykimit të Dhomave të Specializuara në Hagë për rastin e katër drejtuesve kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët njëkohësisht kanë qenë ndër figurat qendrore të luftës çlirimtare dhe të procesit të shtetndërtimit të Kosovës, populli i Kosovës pret që kjo gjykatë të jetë në nivelin e përgjegjësisë historike që ka marrë përsipër. Pritja nuk është vetëm për një vendim juridik. Është pritja që drejtësia të ndahet nga politika, prova të ndahet nga propaganda dhe përgjegjësia individuale të ndahet nga përpjekjet për komprometimin e një lufte çlirimtare. Prandaj, pritja ime është e qartë: një aktgjykim i plotë lirues për katër krerët e UÇK-së, pasi pas gjithë këtij procesi të gjatë Prokuroria nuk ka arritur ta dëshmojë fajësinë e tyre përtej dyshimit të arsyeshëm. Kjo pritje nuk mbështetet vetëm në emocionin tim si një prej bashkëpunëtorëve të të akuzuarve gjatë luftës dhe në procesin e shtetëndërtimit të Kosovës, por edhe në pritjet e natyrshëm të një populli që e ka përjetuar luftën, por para së gjithash në argumentin juridik. Katër të akuzuarit nuk duhet të gjykojnë për faktin se kanë qenë drejtues të UÇK-së, as për shkak të rolit të tyre politik e historik dhe as për shkak të peshës që kanë pasur në procesin e çlirimit dhe të shtetndërtimit të Kosovës. Ata mund të dënohen vetëm nëse provohet, individualisht dhe përtej dyshimit të arsyeshëm, se kanë kryer ose kanë marrë pjesë në krimet konkrete për të cilat akuzohen. Kjo është baza e drejtësisë penale dhe pikërisht kjo bazë duhet të jetë vendimtare në Hagë. Dimensionin politik i kësaj gjykatë nuk mund të anashkalohet. Dhomat e Specializuara u krijuan në një rrethanë të veçantë politike, menjëherë pas një prej fitoreve më të rëndësishme ndërkombëtare të Kosovës: Opinioni të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të vitit 2010, i cili konstatoi se deklarata e pavarësisë së Kosovës nuk kishte shkelur të drejtën ndërkombëtare. Pikërisht në këtë periudhë u intensifikua një fushatë ndërkombëtare që e vendosi UÇK-në në qendër të një narrative të re akuzuese. Raporti i Dick Marty-t dhe proceset politike që pasuan krijuan një perceptim jashtëzakonisht të rëndë ndërkombëtar për

pretendimet lidhur me krimet e luftës dhe trafikimin e organeve. Nën këtë tryzni dhe në kuadër të angazhimeve të saj me partnerët ndërkombëtarë, Kosova miratoi ndryshimet kushtetuese dhe ligjore që mundësuan krijimin e Dhomave të Specializuara. Kjo kronologji politike është e rëndësishme jo për të paragjykuar gjykatën, por për të kuptuar burimin e një prej problemeve themelore të këtij procesi: rrezikun që një mekanizëm i krijuar për të gjykuar krime individuale të perceptohet dhe të funksionojë si mekanizëm për komprometimin e UÇK-së dhe të luftës së Kosovës. Pikërisht këtu duhet të vendoset kufiri midis drejtësisë dhe politikës. Një gjykatë penale nuk mund të marrë përsipër detyrën e rishkrimit të historisë dhe, aq më pak, nuk mund të lejojë që një luftë çlirimtare të shndërrohet në një projekt të përgjithshëm kriminal. Për më tepër, pas një periudhe kaq të gjatë funksionimi dhe pas viteve të gjykimit, kjo gjykatë duhet të japë përgjigje edhe për mënyrën se si e ka ushtruar mandatin e saj. Prej fillimit kam ngritur publikisht dhe në mënyrë sistematike një numër të madh çështjesh juridike e procedurale që lidhen me funksionimin e saj, të cilat i kam trajtuar edhe në librin tim “Gjykata Speciale midis të vërtetës dhe mashtrimeve”, ku kam analizuar një nga një problemet që lidhen me mosrespektim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, legjislacionin penal e procedural, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet ndërkombëtare të gjykimit të drejtë. Këto shqetësime nuk kanë qenë thjesht politike; ato kanë prekur vetë arkitekturën juridike të këtij procesi. Problemi më i madh material, sipas këtij vlerësimi kritik, lidhet me mënyrën se si është ndërtuar akuza mbi konceptin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Kjo teori kërkon një lidhje konkrete ndërmjet të akuzuarve dhe qëllimit kriminal të ndërmarrjes, jo thjesht ekzistencën e një organizate politike apo ushtarake dhe as faktin se individët kanë pasur pozita drejtuese. Prandaj, pyetja thelbësore është nëse është provuar ekzistenca e qëllimit kriminal - (dolus specialis) dhe nëse këta katër persona kanë marrë pjesë me vetëdije në një projekt kriminal. Këtu qëndron një kontradiktë themelore e narrativës së aktakuzës: UÇK-ja doli nga një realitet represioni dhe lufte, u organizua për çlirimin e Kosovës dhe veprimi në kushtet e një konflikti të armatosur kundër forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Serbisë. Për ta transformuar këtë realitet historik në një “ndërmarrje të përbashkët kriminale” kërkohet një nivel prove shumë më i lartë sesa thjesht dëshmia e



ekzistencës së strukturave politike, ushtarake apo komunikimeve ndërmjet drejtuesve. Edhe argumenti mbi strukturën dhe kontrollin duhet të trajtohet me shumë kujdes. UÇK-ja nuk ishte ushtri klasike shtetërore, e ndërtuar mbi modelin e një aparati ushtarak të një shteti të konsoliduar. Ajo ishte një lëvizje guerile e armatosur çlirimtare që u zhvillua në kushte të jashtëzakonshme, kryesisht nga poshtë-lart, nëpërmjet organizimeve lokale dhe zonave operative. Një aspektin procedural, shqetësimet janë po aq serioze. Një nga çështjet më të diskutueshme ka qenë krijimi i një regjimi të posaçëm procedural përmes Rregullave të Procedurës dhe Provave dhe raporti i tyre me sistemin juridik të Kosovës dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Një gjykatë e veçantë nuk mund të shndërrohet në një hapësirë juridike ku standardet themelore të gjykimit të drejtë relativizohen. Përkundrazi, sa më i veçantë të jetë mandati i një gjykate, aq më të larta duhet të jenë standardet e transparencës, barazisë së armëve, mbrojtjes së të akuzuarve dhe arsyetimit gjyqësor. Edhe kohëzgjatja e jashtëzakonshme e procesit ka ngritur pikëpyetje serioze. Një proces penal që zgjatet për vite të tëra, ndërsa të akuzuarit mbahen në paraburgim për periudha jashtëzakonisht të gjata, nuk mund të konsiderohet çështje thjesht administrative. Liria e personit është një e drejtë themelore dhe paraburgimi duhet të mbetet masë e jashtëzakonshme, e justifikuar vazhdimisht me arsye konkrete. Në një rast ku të akuzuarit janë persona publikë, të njohur ndërkombëtarisht dhe që kanë qenë vazhdimisht subjekt i procedurave gjyqësore, arsyetimi për vazhdimin e pafund të paraburgimit duhet të jetë veçanërisht bindës. Një tjetër shqetësim i rëndësishëm lidhet me transparencën. Seancat e

mbyllura, materialet e redaktuara dhe kufizimi i informacionit publik kanë krijuar një distancë të madhe ndërmjet këtij procesi dhe opinionit publik. Sigurisht, mbrojtja e dëshmitarëve dhe interesat legjitime të drejtësisë mund të kërkojnë kufizime të caktuara. Por për një gjykatë që vendos mbi një kapitull kaq të rëndësishëm të historisë së Kosovës, transparenca nuk është luks; është kusht i besueshmërisë. Po aq shqetësues është perceptimi për pabarazi ndërmjet palëve dhe për një pozitë tepër dominante të Prokurorisë gjatë procesit. Trupi gjykues nuk është palë e Prokurorisë. Roli i tij është të garantojë ekuilibrin procedural, të mbrojë të drejtat e të akuzuarve dhe të sigurojë që çdo provë të vlerësohet në mënyrë të paanshme. Një gjykatë nuk mund të jetë vetëm formalisht e pavarur; ajo duhet të jetë e dukshme dhe bindshëm e pavarur. Në këtë kuadër duhet të trajtohet edhe burimi i provave. Çdo provë që vjen nga Serbia si shtet armiqësor ndaj Kosovë, duhet të vlerësohet me rigorozitetin maksimal të mundshëm, jo për shkak të origjinës së saj në vetvete, por për shkak të nevojës për të verifikuar autenticitetin, besueshmërinë, kontekstin dhe mënyrën e krijimit të saj. Serbia nuk ka qenë një palë neutrale në konfliktin e Kosovës; ajo ka qenë agresore dhe ushtruese e politikave gjenocidale ndaj popullit të Kosovës. Prandaj, asnjë material nuk duhet të marrë peshë të veçantë vetëm sepse është paraqitur si dokument zyrtar. Në një proces penal, dokumenti duhet të bindë me përmbajtjen dhe autenticitetin e tij, jo me autoritetin e institucionit që e ka prodhuar. Pas gjithë kësaj, pyetja që shtrohet para Dhomave të Specializuara është historike: a do të mbizotërojë prova mbi narrativën, drejtësia mbi politikën dhe përgjegjësia individuale mbi përgjegjësinë

kolektive? Sepse nëse gjykata do të lejonte që drejtuesit e UÇK-së të dënohen mbi bazën e pozitës së tyre, të historisë së organizatës që kanë drejtuar ose të një narrative të përgjithshme për karakterin e luftës, atëherë do të krijohet një precedent jashtëzakonisht problematik. Do të rrezikohet që një proces penal të përdoret për komprometimin juridik të një lufte çlirimtare dhe delegjitimitimin e figurave që udhëhoqën Kosovën drejt çlirimit dhe shtetndërtimit. Prandaj, sot, në prag të vendimit, duhet të jemi optimistë, por ky optimizëm duhet të jetë optimizëm juridik. Ai buron nga një parim që nuk mund të negociohet: nëse Prokuroria nuk ka provuar përtej dyshimit të arsyeshëm përgjegjësinë individuale të katër të akuzuarve, ata duhet të lirohen. Rregulla 140 e Rregullave të Procedurës dhe Provave e vendos këtë standard në themel të vendimmarrjes, ndërsa Rregulla 130 e lidh mungesën e provës së mjaftueshme me mundësinë e rrëzimit të akuzave. Në këtë pikë, një aktgjykim lirues do të ishte shumë më tepër se lirimi i katër individëve. Do të ishte një fitore e provës kundër propagandës; një fitore e drejtësisë kundër politikës dhe një fitore e së vërtetës historike kundër përpjekjeve për komprometimin e luftës së Kosovës. Kosova nuk kërkon që askush të jetë mbi ligjin. Kosova kërkon që ligji të jetë mbi politikën. Nuk kërkon privilegj për krerët e UÇK-së. Kërkon që ata të gjykojnë me të njëjtin standard që do të zbatohet ndaj çdo qytetari tjetër. Nuk kërkon që krimet eventuale të mohohen. Kërkon që ato të provohen individualisht dhe jo të shndërrohen në një instrument për të kriminalizuar një luftë dhe një popull. Prandaj, pritja ime si juristë është e qartë dhe shpresa ime është e madhe: katër krerët e UÇK-së duhet të kthehen të lirë në Kosovë. Nëse drejtësia e ka fjalën e fundit, nëse prova është mbi narrativën dhe nëse standardi “përtej dyshimit të arsyeshëm” zbatohet realisht, atëherë aktgjykimi lirues është jo vetëm i mundshëm, por përfundim i drejtësisë duhet ta japë kur fajësia nuk është provuar. Ky do të ishte një moment i madh për Kosovën, por edhe një moment i madh për vetë Dhomat e Specializuara. Sepse një gjykatë dëshmon pavarësinë e saj jo kur dënon, por kur është e gatshme të lirojë edhe atëherë kur mbi të ushtrohen pritshmëri të fuqishme politike. Nëse provat nuk mjaftojnë, vetëm pafajësia është drejtësi. Krerët e UÇK-së nuk duhet të gjykojnë për historinë e Kosovës. Aktgjykimi duhet të jetë i qartë: PAFAJËSI. Drejtësia nuk duhet ta komprometojë luftën çlirimtare të Kosovës. Drejtësia duhet ta mbrojë të vërtetën përmes ligjit.

SOT NË PRISHTINË MBAHET 'MARSHI PËR LIRI', PRITET PJESËMARRJE MASIVE NGA E GJITHË KOSOVA

Sot (e shtunë) në Prishtinë do të mbahet "Marshi për Liri", i organizuar nga platforma "Liria ka Emër", me thirrjen që qytetarët nga të gjitha komunat e Kosovës t'i bashkohen protestës në përkrahje të krerëve të UÇK-së. Marshi do të nisë në orën 14:00 në Sheshin "Skënderbeu". Organizatorët kanë njoftuar se nga qytete dhe vendbanime të shumta të Kosovës do të ketë autobusë të organizuar drejt Prishtinës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Sot, më 12 shtator, në Prishtinë do të mbahet "Marshi për Liri", i organizuar nga platforma "Liria ka Emër", me thirrjen që qytetarët nga të gjitha komunat e Kosovës t'i bashkohen protestës në përkrahje të krerëve të UÇK-së. Marshi do të nisë në orën 14:00 në Sheshin "Skënderbeu". Përfaqësuesit e platformës qytetare "Liria ka Emër", Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, u kanë bërë thirrje qytetarëve të marrin pjesë në "Marshin për Liri", që do të mbahet në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, në mbështetje të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Përfaqësuesja e LKE-së, Eliza Hoxha, ka paraqitur programin dhe folësit e Marshit. "Në emër të platformës 'Liria ka Emër' do të flasim ne të dy së bashku, do ta hapim, në fakt, pjesën formale të Marshit. Në emër të shoqatave të dala nga lufta do të flasë Hysni Gucati. Do të flasë Liriona Sulejmani në emër të fëmijëve të dëshmorëve, si vajza e dëshmorit Bajram Sulejmani, duke sjellë zërin dhe mesazhin e një brezi që trashëgon kujtesën dhe sakrificën e luftës edhe në familje. Qytetarëve do t'u drejtohen gjithashtu Ardian Gjini dhe Bedri Hamza, si dhe Buna Mustafa, e bija e Salih Mustafës-Calit. Programi do të shoqërohet edhe me këngë, të cilat do të jenë pjesë e mesazhit të këtij tubimi, këngë patriotike,

natyrisht, që na kanë frymëzuar dhe na kanë kujtuar gjithmonë për përkushtimin tonë për liri", tha Hoxha. Paraprakisht LKE i ka ftuar liderët e katër partive parlamentare shqiptare të marrin fjalën e tyre, për t'iu drejtuar pjesëmarrësve në marsh, mirëpo ftesës i janë përgjigjur pozitivisht vetëm kryetari i PDK-së, Bedri Hamza dhe ai i Aleancës, Ardian Gjini. Hoxha njoftoi se LKE ka organizuar transport me autobusë nga të gjitha qytetet e Kosovës. "Ejani me familjet tuaja, ejani me fëmijët tuaj, ejani me prindërit tuaj, me miqtë tuaj, ejani të gjithë bashkë në Marsh më 12 shtator, në orën 14:00, në Sheshin 'Skënderbeu', që të marshojmë për çlirimtarët tanë", tha Hoxha. Ndërkaq, Ismail Tasholli ftoi qytetarët që t'i bashkohen Marshit, duke theksuar se mesazhi i organizatorëve nga Prishtina deri në Hagë mbetet i



njëjtë: të qëndrojnë të bashkuar dhe pranë njëri-tjetrit në momente që, sipas tij, kanë rëndësi të veçantë. "Prandaj, sot dua t'u drejtoj një ftesë të gjithë qytetarëve. Bashkohuni me ne më 12 shtator, në orën 14:00, në Sheshin 'Skënderbeu' në Prishtinë. Mos ejani vetëm, ejani me familjet tuaja, merrni fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat dhe miqtë tuaj, ashtu siç erdhi edhe Eliza. Le të jetë ky marsh një marsh qytetar, familjar, paqësor dhe dinjitoz. Le të jemi sa më shumë, le të jemi bashkë. Më 12 shtator, ora 14:00, Sheshi 'Skënderbeu'. Dhe më 15 shtator, nga ora 22:00, takohemi përsëri në Hagë, në natën e pritjes, për të qëndruar së bashku deri në nisjen e seancës së gjyqit", tha ai.



Transport i organizuar nga komunat

Në kuadër të përgatitjeve për protestën, organizatorët kanë njoftuar se nga qytete dhe vendbanime të shumta të Kosovës do të ketë autobusë të organizuar drejt Prishtinës. Eliza Hoxha ka thënë se synimi është që largësia të mos jetë pengesë për asnjë qytetar që dëshiron të marrë pjesë në marsh. "Nga qytetet dhe komunat anembanë vendit do të organizohen nisje drejt Marshit. Pikat e nisjes, oraret dhe detajet e transportit do të bëhen publike me kohë përmes njoftimeve tona zyrtare. Mesazhi ynë është i thjeshtë, kudo që jeni, bëhuni gati", ka thënë Hoxha. Organizatorët kanë publikuar gjithashtu oraret dhe pikat e nisjes së autobusëve për komunat e ndryshme, me destinacion Sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë.

Gucati: Të bëhemi një më 12 shtator

Mbështetje për "Marshin për Liri" ka shprehur edhe kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati. Ai u ka bërë thirrje familjeve të dëshmorëve, veteranëve, invalidëve dhe

qytetarëve shqiptarë kudo që ndodhen që t'i bashkohen protestës. "Ju ftoj të bëhemi një më 12 shtator në Prishtinë, ora 14:00, në marshin madhështor në përkrahje të krerëve të UÇK-së, burrave që veshën uniformën e lirisë dhe i dhanë jetë shtetit tonë", ka deklaruar Gucati.

Ai ka theksuar se, sipas tij, kërkesa për drejtësi mbetet në qendër të kësaj proteste.

"Drejtësia nuk është e plotë derisa çlirimtarët tanë të jenë të lirë. Zëri ynë do të dëgjohet fuqishëm. Liria ka emër dhe ajo mbrohet bashkë!", ka thënë Gucati.

Në mbështetje të protestës kanë dalë edhe sindikatat e punëtorëve të kategorive të ndryshme, të cilat kanë shprehur përkrahjen e tyre për "Marshin për Liri".

Organizatorët u kanë bërë thirrje qytetarëve që të shtunën të mblidhen në Prishtinë, duke përcjellë mesazhin që pjesëmarrja të jetë masive, paqësore dhe dinjitoze.

Më 16 shtator 2026 Gjykata Speciale pritet të shpallë vendimin për katër ish-krerë të UÇK-së: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Platforma qytetare "Liria ka Emër" organizon, më 15 dhe 16 shtator, dy tubime në Hagë, në prag dhe në ditën e shpalljes së aktgjykimit për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin. Tubimet do të mbahen në Malieveld në Hagë.

Në Kosovë janë vendosur pankarte dhe pllakate të mëdha me mesazhin "Liria ka emër" dhe fotografi të ish-krerëve të UÇK-së. Gjithashtu ka pasur protesta kundër këtij procesi në Hagë, në Prishtinë dhe në qytete të tjera.

Mijëra qytetarë morën pjesë në protestën "Drejtësi, jo politikë" në Ditën e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt, këtë vit në Prishtinë, në përkrahje të Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit.

MAPL u kërkon tri komunave të emërojnë nënkryetarët për komunitete

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, iu është drejtuar me kërkesë zyrtare kryetarëve të komunave të Mitrovicës së Veriut, Zveçanit dhe Zubin Potokut, për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme në përmbushjen e obligimeve ligjore për përfaqësimin e komuniteteve në institucionet e pushtetit lokal.

Konkretisht, kërkesa përfshin: Emërimin e nënkryetarëve për komunitete; Emërimin e

zëvendëskryesuesve të Kuvendeve Komunale për komunitete. "Këto nuk janë çështje të vullnetit institucional, por obligime të përcaktuara me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës. Është e rëndësishme të theksohet se ka komuna si Gjakova, Lipjani, Ferizaj dhe të tjera, të cilat edhe pse nuk kanë pasur obligim të drejtpërdrejtë ligjor për një përfaqësim të tillë, e kanë përmbushur atë përmes vullnetit politik dhe institucional, duke dëshmuar

përkushtim për gjithëpërfshirje dhe përfaqësim të komuniteteve. Në anën tjetër, është e papranueshme që komunat të cilat e kanë obligim ligjor të mos i kenë përmbushur këto detyrime. Si MAPL do të vazhdojmë të kërkojmë nga të gjitha komunat respektimin dhe zbatimin e plotë të legjislacionit për vetëqeverisjen lokale, duke garantuar përfaqësim, gjithëpërfshirje dhe trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët dhe komunitetet", ka thënë ministri Krasniqi.




Mbi 99 mijë vizitorë qëndruan në hotelet e Kosovës gjatë korrikut

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e hotelesisë për muajin korrik. Në korrik 2026 numri i vizitorëve në hotele ishte 99 053, prej tyre vizitorë vendorë ishin 32 098 dhe vizitorë të jashtëm ishin 66

954. Kraheluar me muajin korrik të vitit 2025 (sa ishin 77 481 vizitorë), pati rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve në hotele për 27,8 %. Numri i net-qëndrimeve ishte 217 798, prej tyre 149 509 (68,6 %) nga vizitorët e jashtëm dhe 68 289 (ose 31,3

%) vendorët e brendshëm. Sa iu përket vizitorëve të huaj në muajin korrik 2026, krahasuar me periudhën paraprake (korrik 2025), pati rritje të vizitorëve për 31,7 %. Në total, 66 954 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh ishte nga: Shqipëria, Gjermania, Zvicra, Turqia etj.



SHQIPËRIA DHE FIRMA AMERIKANE NËN SHKRUAJNË MEMORANDUM PËR VLERËSIMIN E NDËRTIMIT TË NJË TERMINALI PËR LNG

TRANË, 11 SHTATOR - Zhvilluesi amerikan i projekteve të gazit të lëngshëm natyror (LNG), Argent LNG, ka njoftuar se ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Qeverinë e Shqipërisë për ta vlerësuar ndërtimin e një terminali në tokë për ruajtjen dhe rigazifikimin e LNG-së, me kapacitet deri në 5 milionë tonë në vit. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Shqipërisë konfirmoi për Radio Evropa e Lirë nënshkrimin e memorandumit të mërkurën. Terminali mund të lidhet me Gazsjellësin Trans-Adriatik (TAP), Gazsjellësin e propozuar Jon-Adriatik (IAP) dhe korridorin e gazit Fier-Vlorë. Terminali i propozuar do të projektohej për t'i furnizuar tregjet në Ballkanin Perëndimor dhe Evropën Juglindore dhe, sipas Argent LNG-së, mund ta mbështesë Ukrainën përmes marrëveshjeve rajonale në tregun e gazit. Kompania nuk dha ndonjë vlerësim për koston, as nuk bëri me dije nëse është propozuar vendi për ndërtimin dhe nuk tregoi nëse ishte caktuar ndonjë afat kohor për ndërtimin e terminalit në Shqipëri. Por, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i tha Radios Evropa e Lirë se terminali do të ndërtohej në Vlorë, në jug të Shqipërisë. Argent LNG tha se financimi mund ta përfshijë Agjencinë Amerikane për Tregti dhe Zhvillim (USTDA), Korporatën Amerikane të Financimit Ndërkombëtar për Zhvillim (DFC) dhe Bankën Amerikane të

Eksport-Importit (EXIM Bank). Në korrik, Departamenti Amerikan i Energjisë autorizoi Argent LNG-në të eksportojë LNG nga terminali i saj i propozuar në Port Fourchon, Luiziana, drejt vendeve që kanë marrëveshje të tregtisë së lirë me Shtetet e Bashkuara. Projekti parashikohet të jetë pjesë e një arkitekture më të gjerë rajonale, të hartuar për ta forcuar qëndrueshmërinë energetike të Evropës dhe Ukrainës. Ky njoftim vjen në një kohë kur Kosovës vazhdimisht i është bërë thirrje për t'iu bashkuar projektit të aleatit të vet më të madh për furnizim me LNG. Në korrik, kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, tha se vendi po e shqyrton mundësinë për ta përdorur gazin e lëngëzuar (LNG) nga Shtetet e Bashkuara në të ardhmen.

Më shumë rreth memorandumit

Marrëveshja ndërtohet mbi memorandumet e mirëkuptimit të njoftuara më parë nga Argent LNG me Naftogaz Group të Ukrainës, të nënshkruar në korrik 2026, dhe Transgaz të Rumanisë, të nënshkruar në gusht 2026. Sipas kompanisë, këto marrëveshje e pozicionojnë Shqipërinë si një pikë hyrëse në Adriatik dhe Ballkanin Perëndimor të një arkitekture të unifikuar rajonale të furnizimit, të mbështetur nga LNG-ja amerikane. Shqipëria është shtet anëtar i Nismës së Tre Deteve dhe palët synojnë ta zhvillojnë dhe



pozicionojnë terminalin si një projekt kryesor të kësaj nisme për sigurinë energetike. Palët do të krijojnë një grup të përbashkët pune për ta avancuar studimin e fizibilitetit dhe vlerësimin e vendndodhjes, planifikimin teknik të ndërlidhjeve dhe një strukturë financimi që përfshin mbështetje nga Agjencia Amerikane për Tregti dhe Zhvillim (USTDA), Korporata Financiare Ndërkombëtare për Zhvillim e ShBA-së (DFC) dhe Banka Amerikane e Eksport-Importit (EXIM). Afati i zhvillimit të terminalit do të harmonizohet me objektivin e Argent LNG për ngarkesën e parë të LNG-së nga Port Fourchon në vitin 2030. Jonathan Bass, kryetar dhe CEO i Argent LNG, tha pas nënshkrimit

të marrëveshjes se Shqipëria ka mundësinë të shërbejë si një pikë e sigurt furnizimi, e mbështetur nga ShBA-ja, që forcon sigurinë energetike të fqinjëve të saj dhe qëndron përkrah Ukrainës në një moment kur energjia është përdorur si armë kundër këtij rajoni. "Jemi krenarë që jemi partnerë me Qeverinë e Shqipërisë në një projekt që pasqyron si leadershipin energjetik amerikan, ashtu edhe rolin e Shqipërisë në avancimin e objektivave të Nismës së Tre Deteve dhe të sigurisë energetike transatlantike", tha drejtuesi i kompanisë amerikane. Enea Karakaçi, ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë, vlerësoi se memorandumit i mirëkuptimit

pasqyron angazhimin e Shqipërisë për forcimin e sigurisë energetike dhe sigurisë së furnizimit në të gjithë rajonin. "E mirëpresim këtë partneritet dhe e shohim atë si një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit transatlantik në fushën e energjisë dhe në pozicionimin e Shqipërisë si një vend pritës i besueshëm për infrastrukturën kritike energetike rajonale", tha Karakaçi. Kompania amerikane thotë se po ndërton një portofol partneritetesh qeveri-me-qeveri dhe tregtare në Evropë, Lindjen e Mesme dhe Afrikën Perëndimore, për të ofruar LNG të sigurt, me origjinë nga ShBA-ja, për vendet aleate dhe partnere. Ndërkohë, në prill, Shqipëria nënshkroi një marrëveshje në fushën e sigurisë energetike, me vlerë të deklaruar 6 miliardë dollarë, mes Albgaz dhe dy kompanive ndërkombëtare, njëra amerikane, tjetra greke. Marrëveshja parashikonte zhvillimin e Qendrës Energetike të Vlorës dhe një marrëveshje kuadër për furnizimin me gaz natyror të lëngshëm. Synimi ishte krijimi i infrastrukturës në Vlorë për importimin e LNG-së nga ShBA-ja dhe rigazifikimin e tij për furnizimin e tregjeve të Evropës Jugore. Në atë kohë kryeministri Edi Rama tha se Vlorë synohet të shndërrohet në një pikë kritike energetike për Evropën Juglindore dhe Shqipëria në një vend ndërlidhës për flukset energetike rajonale.

ZKA-ja mori pjesë në tryezën "Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit: Nga rreziqet te zgjidhjet"

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Drejtori i Departamentit të Auditimit në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA), Faruk Rrahmani, mori pjesë në tryezën "Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit: Nga rreziqet te zgjidhjet", organizuar nga Sbunker, ku u paraqitën tre raporte mbi rreziqet e korrupsionit dhe u diskutua për adresimin e tyre. Gjatë prezantimeve në panel, Rrahmani theksoi rolin e auditimit në forcimin e

llogaridhënies, transparencës dhe kontroleve të brendshme, duke veçuar gjetjet e auditimeve në menaxhimin e fondeve publike, prokurimin publik dhe luftimin e mashtrimit të korrupsionit. Ai foli edhe për bashkëpunimin e ZKA-së me institucionet e drejtësisë dhe mekanizmat e krijuar për identifikimin dhe trajtimin e rasteve me elemente të mashtrimit apo veprave penale.

Pjesë e panelit ishte edhe drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll Buleshkaj, dhe prokurori i Njësisë për Lëndët e Korrupsionit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Zef Prendrecaj. Në përmbyllje të tryezës përfaqësuesit e institucioneve u pajtuan me gjetjet e raporteve dhe u zotuan se do t'i adresojnë në përputhje me mandatet e tyre.



KËRCËNIMI I HESHTUR NGA VIRUSI VDEKJEPRURËS, QË RREZIKON DHE SHQIPËRINË

Ai e dallon prenë e saj edhe nga një distancë deri në 200 metra. Ndryshe nga shumë insekte të tjerë, ky insekt nuk pret e fshehur në bar derisa viktima t'i afrohet. Ai vrapon, ndjek lopë, dele ose njerëz dhe në fund pickon. Më parë, insekti Hyalomma ishte i përhapur kryesisht në Afrikë, Azi dhe Evropën Jugore. Sot, falë ndryshimeve klimatike, ajo gjen kushte ideale për mbijetesë edhe më në veri. Ai tashmë është shfaqur në Gjermani dhe në disa vende të Evropës Lindore. Kosova prej kohësh konsiderohet një pikë e nxehtë e përhapjes së saj. Kjo nuk do të ishte aq problematike po të mos ishte fakti se insekti Hyalomma është bartës i një virusi shumë patogjen, virusit Krime-Kongo (Orthonairovirus haemorrhagiae). Ky virus mund të shkaktojë Ethet Hemorragjike Krime-Kongo (CCHF), një sëmundje me simptoma të ngjashme me ato të virusit Ebola dhe virusit Marburg. Këto viruse mund të dëmtojnë enët e gjakut dhe limfës, duke shkaktuar hemorragji të brendshme dhe madje vdekje.

Fillimi i një partneriteti gjermano-kosovar

Në vitin 2005, Kurtesh Sherifi lexon në gazetë për ethet Krime-Kongo. Ai është mjek veterinar dhe po përfundonte doktoraturën e tij në Berlin. Gazeta raportonte se në Kosovë njëmbëdhjetë persona ishin infektuar me sëmundjen dhe pesë prej tyre kishin humbur jetën. Sëmundjet që kalojnë

nga kafshët te njerëzit, të njohura si zoonoza, e kishin interesuar gjithmonë dhe virusi Krime-Kongo i dukej veçanërisht interesant nga pikëpamja shkencore. Sherifi punësohet në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjekësisë Veterinare të Universitetit të Prishtinës. Megjithatë, fondet për kërkim shkencor janë të kufizuara. Në Kosovë, një vend i vogël me rreth 1.6 milion banorë, nuk kishte as laborator të sigurisë së lartë dhe as pajisjet e nevojshme për diagnostikimin e virusit Krime-Kongo. Prandaj, ai i drejtohet Institutit Bernhard Nocht për Mjekësinë Tropikale (BNITM) në Hamburg. Atje ekzistojnë të gjitha pajisjet e nevojshme dhe stafi i trajnuar për këtë punë. Njëra prej tyre është Petra Emmerich, virologe në BNITM dhe specialiste për diagnostikimin e viruseve të grupit të rrezikut 4, ku bën pjesë edhe virusi Krime-Kongo. Emmerich është gjithashtu rezerviste në Bundeswehr (Forcat e Armatosura Gjermane), të cilat interesohen për viruse shumë patogjene që mund të përdoren edhe si armë biologjike. Në vitin 2009 ajo dërgohet në Kosovë në cilësinë e virologes dhe aty takohet me Kurtesh Sherifin. Kështu fillon një bashkëpunim intensiv në shkëmbimin e njohurive dhe studiuve. Në Kosovë nis ngritja e një sistemi për monitorimin e përhapjes së rriqave dhe diagnostikimin e virusit. Në vitin 2013, puna e përbashkët shkencore merr mbështetje të rëndësishme financiare përmes Programit të Biosigurisë të Ministrisë së Jashtme Gjermane.

Çfarë mësojnë Gjermania dhe Kosova nga njëra-tjetra

“Është një proces i ndërsjellë shkëmbimesh,” thotë Petra Emmerich. “Ne kemi ekspertizën diagnostikuese dhe mjetet e nevojshme, por nuk kemi pacientët.” Për këtë arsye, ajo sjell rregullisht mjekë nga Gjermania për të shkëmbyer përvoja me mjekët e klinikave në Kosovë. Një shtyllë tjetër e rëndësishme e bashkëpunimit është edukimi i popullatës. Veçanërisht shpesh infektohen fermerët në Kosovë. Jo vetëm përmes pickimit nga rriqat e infektuara, por edhe kur i heqin ato me duar të zhveshura nga gjiri i kafshëve. Nëse gjaku i infektuar i kafshës bie në kontakt me një plagë të vogël në lëkurën e dorës, virusi mund të transmetohet. “Ka shumë të ngjarë që një pjesë e madhe e njerëzve në Kosovë infektohen në këtë mënyrë,” thotë Sherifi. Ai dhe Emmerich vizitojnë gjithashtu shkolla për të informuar nxënësit mbi rrezikun e virusit dhe masat mbrojtëse: përdorimin e repelentëve kundër rriqave, pantallona të gjata dhe këpucë të mbyllura. Problemi është se kundër etheve Krime-Kongo nuk ka as vaksinë dhe as terapi specifike.

Pse ethet Krime-Kongo janë kaq të rrezikshme

Shumica e infeksioneve nuk shkaktojnë simptoma. “Por

nëse sëmureni, atëherë mund të jetë shumë e rëndë,” thotë Emmerich. Sëmundja fillon me simptoma të përgjithshme që ngjasojnë me gripin: temperaturë, të dridhura, dhimbje muskujsh dhe koke. Në rastet e rënda, pasojnë gjakderdhje në lëkurë, hundë dhe mishra të dhëmbëve, si dhe hemorragji në traktin gastrointestinal. Mund të ndodhë edhe dështim i organeve. Pacientët duhet të trajtohen në kujdes intensiv dhe të izoloohen, pasi janë shumë ngjitës. Përveç trajtimit intensiv që synon ruajtjen e funksioneve jetësore, pacientëve u jepet edhe ilaçi antiviral Ribavirin. Por sipas Emmerich, “Ribavirina ka shumë pak efekt te pacientët në gjendje akute”. Kjo është vërtetuar jo vetëm nga studimet, por edhe nga rastet që ata kanë trajtuar në Kosovë.

Edukimi dhe monitorimi japin rezultate

Pikërisht për këtë arsye është shumë e rëndësishme të monitorohet vazhdimisht përhapja e riqërrave dhe virusit, në mënyrë që zonat me rrezik të identifikohen dhe, nëse është e nevojshme, të shmangen. Gjatë viteve, studiuesit kanë mbledhur mijëra riqërra dhe kanë kryer studime të seroprevalencës, ku analizohen mostrat e gjakut për praninë e antitropave kundër virusit. Kjo u mundëson të përcaktojnë nëse njerëzit ose kafshët kanë qenë në kontakt me virusin. Për këtë qëllim, kafshët

shtëpiake janë veçanërisht të përshtatshme, thotë Sherifi, sepse virusi zakonisht nuk u shkakton sëmundje. Ndryshe nga kafshët e egra dhe njerëzit, ato qëndrojnë në zona të kufizuara. Nëse në gjakun e tyre gjenden antitropa, kjo tregon qartë se virusi qarkullon në atë rajon. Në Kosovë, numri i infektimeve ka rënë ndjeshëm gjatë dhjetë viteve të fundit, në vetëm pesë raste gjithsej. Për krahasim, në dhjetëvjeçarin e mëparshëm ishin dokumentuar 100 raste të sëmundjes. Sherifi dhe Emmerich e konsiderojnë këtë një sukses të madh të punës së tyre. Megjithatë, të dy presin që insketi dhe virusi të vazhdojnë të përhapen. Në Francë, për shembull, së fundmi janë zbuluar rriqa Hyalomma të infektuara me virusin Krime-Kongo. Deri tani nuk është raportuar asnjë infektim i njeriut. “Gjatë 13 viteve të fundit, riqërrat Hyalomma janë përhapur gjeografikisht,” thotë Emmerich. “Si virologe, kjo të bën të mendosh seriozisht dhe kërkon vëzhgim të kujdesshëm.” Për këtë arsye, Kurtesh Sherifi e konsideron të rëndësishme që të gjitha njohuritë që ka fituar nga dhe me studiuesit gjermanë t'i ndajë me vende të tjera që ende nuk kanë shumë përvojë në monitorimin dhe diagnostikimin e rriqave dhe virusit Krime-Kongo, si Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria. Këto janë rajone të reja ku rriqa dhe virusi po zgjerojnë aktualisht praninë e tyre. (DW)



11 SHTATORI I PËRGJAKSHËM I KILIT: SI ERDHI PINOCHETI NË PUSHTET DHE KUSH E VRAU ALLENDE?

Për herë të parë që nga rikthimi i demokracisë në Kili, qeveria e vendit nuk do të organizojë një ceremoni zyrtare për të përkujtuar 11 shtatorin, datën kur në vitin 1973 u rrëzua me grusht shteti presidenti i zgjedhur Salvador Allende. Presidenti aktual, José Antonio Kast, do të vijojë agjendën e tij institucionale dhe do të jetë i angazhuar në aktivitete në rajonin e Los Ríos.

Vendimi ka shkaktuar debate edhe brenda shumicës qeverisëse, ndërsa opozita e ka kritikuar presidentin duke i kujtuar se ai është president i të gjithë kilianëve, përfshirë familjet e viktimave të diktaturës.

Por 11 shtatori mbetet një nga datat më të ndjeshme dhe më përcarëse në historinë moderne të Kilit.

Në fund të viteve '60 dhe fillim të viteve '70, Kili ishte një nga demokracitë më të konsoliduara të Amerikës Latine. Por shoqëria ishte thellësisht e ndarë politikisht. Në njërën anë ishte e majta, e cila kërkonte reforma të thella sociale dhe ekonomike. Në anën tjetër ishin forcat konservatore dhe një pjesë e rëndësishme e klasës së mesme dhe elitave ekonomike, të cilat e shihnin me shqetësim zgjerimin e ndikimit të socialistëve dhe komunistëve.

Në këtë klimë u zhvilluan zgjedhjet presidenciale të vitit 1970.

Salvador Allende, një socialist dhe drejtues i koalicionit të majtë Unidad Popular, mori rreth 36.2% të votave. Konservatori Jorge Alessandri mori rreth 34.9%, ndërsa kandidati demokristian Radomiro Tomic rreth 27.8%.

Asnjë kandidat nuk arriti shumicën absolute.

Sipas Kushtetutës së atëhershme, vendimi i takonte Kongresit. Pas negociatave dhe garancive kushtetuese, Kongresi zgjodhi Allenden president më 24 tetor 1970.

Kështu, Allende u bë një figurë unike në historinë e Luftës së Ftohtë: një marksist që kishte ardhur në pushtet përmes zgjedhjeve dhe që synonte të ndërtonte socializmin duke përdorur institucionet demokratike.

Programi i tij parashikonte reforma të mëdha. Qeveria nacionalizoi industri strategjike, përfshirë sektorin e bakrit, zgjeroi rolin e shtetit në ekonomi, vazhdoi reformën agrare dhe rriti pagat dhe shpenzimet sociale.

Për mbështetësit e tij, kjo ishte një përpjekje për t'i dhënë më shumë pushtet dhe mirëqenie shtresave të varfra.

Për kundërshtarët, ishte një rrugë drejt një regjimi socialist të ngjashëm me Kubën.

Zgjedhja e Allendes ndodhi në kulmin e Luftës së Ftohtë dhe qeveria amerikane e Richard Nixon e konsideronte ardhjen e

një presidenti marksist në pushtet në Amerikën e Jugut si një kërcënim strategjik.

Shtetet e Bashkuara ndërmorën një sërë masash për të izoluar dhe dobësuar qeverinë e Allendes.

Dokumentet e deklasifikuara amerikane kanë treguar për financim të fshehtë të forcave politike kundërshtarë dhe përpjekje për të penguar konsolidimin e pushtetit të tij.

Washingtoni mbështeti gjithashtu masa ekonomike dhe politike që kontribuan në presionin ndaj qeverisë së Allendes.

Megjithatë, historia është më komplekse sesa pretendimi se “SHBA-të organizuan drejtpërdrejt grushtin e shtetit”. Ndërhyrja amerikane dhe përpjekjet për destabilizim janë të dokumentuara, por roli i drejtpërdrejtë i SHBA-ve në planifikimin dhe ekzekutimin e grushtit të shtetit të 11 shtatorit mbetet çështje e debatit historik.

Ndërsa përplasja politike thellohej, ekonomia e Kilit filloi të përballej me probleme të mëdha.

Inflacioni u rrit ndjeshëm, pati mungesa të produkteve bazë, rënie të prodhimit dhe probleme me furnizimet. Grevat dhe protestat u shtuan.

Në vitin 1972, një grevë e gjatë e transportuesve paralizoi pjesë të rëndësishme të ekonomisë. Në rrugë dhe në parlament, përplasjet mes së majtës dhe opozitës u bënë gjithnjë e më të ashpra.

Kili po shkonte drejt një krize të thellë politike.

Në qershor 1973 ndodhi një përpjekje e parë për grusht shteti, e njohur si “Tanquetazo”. Ajo dështoi.

Gjenerali Carlos Prats, komandanti i ushtrisë dhe një mbështetës i idesë se ushtria duhet të qëndronte jashtë politikës, dha dorëheqjen në gusht.

Në vend të tij, Allende emëroi gjeneralin Augusto Pinochet si komandant të ushtrisë më 24 gusht 1973.

Vetëm 18 ditë më vonë, ai do të bëhej një nga drejtuesit kryesorë të grushtit të shtetit.

Në orët e para të 11 shtatorit,



forcat e armatosura dhe policia nisën kryengritjen kundër qeverisë.

Allende u drejtua për në pallatin presidencial, La Moneda.

Rreth orës 07:30, ai mbërriti në pallat së bashku me bashkëpunëtorët dhe një grup të vogël njerëzish të armatosur që do të përpiqeshin ta mbronin.

Situata po përkeqësohej me shpejtësi.

Forcat ushtarake i kërkuan Allendes të dorëhiqej dhe të largohej nga pallati.

Në një fjalim të transmetuar në radio, Allende u tha kilianëve se nuk do të dorëzohej. Ai e dinte se situata ishte pothuajse e pashpresë, por vendosi të qëndronte në La Moneda.

Rreth mesditës, ushtria nisi sulmin ndaj pallatit presidencial. Në orën 11:52, avionët luftarakë bombarduan La Monedën.

Ndërtesa presidenciale u përfshi nga zjarri dhe tymi. Brenda saj, Allende dhe njerëzit që ndodheshin me të përpqeshin të rezistonin.

Por forcat ushtarake po afroheshin gjithnjë e më shumë. Pas disa orësh rezistencë, gjithçka mori fund.

Rreth orës 13:40, Salvador Allende u gjet i vdekur brenda La Monedës.

Sipas versionit të konfirmuar nga hetimet dhe burimet zyrtare kiliane, Allende kreu

vetëvrasje me armën që kishte me vete.

Për vite me radhë pati spekulime se ai mund të ishte vrarë, por hetimet e mëvonshme e konfirmuan vetëvrasjen. Në një nga ditët më dramatike të historisë së Kilit, presidenti i zgjedhur demokratikisht kishte vdekur ndërsa ushtria po merrte kontrollin e vendit.

Pas vdekjes së Allendes, pushteti kaloi në duart e një grupi ushtarakësh të përbërë nga drejtuesit e katër forcave kryesore të sigurisë: Augusto Pinochet për ushtrinë, Gustavo Leigh për forcat ajrore, José Toribio Merino për marinën dhe César Mendoza për karabinierët.

Kili hyri në një periudhë diktature që do të zgjaste 17 vite.

Regjimi i Pinochetit u shoqërua me arrestime masive, tortura, ekzekutime dhe zhdukje të detyruara.

Mijëra njerëz u arrestuan për arsye politike dhe shumë prej tyre u torturuan në qendrat e paraburgimit.

Sipas të dhënave të komisioneve zyrtare kiliane të së vërtetës, më shumë se 3 mijë persona u vranë ose u zhdukën për arsye politike, ndërsa mbi 38 mijë persona u njohën si viktimat të burgimit politik dhe torturës.

Për familjet e këtyre njerëzve, 11 shtatori nuk është thjesht një kapitull historie. Është dita kur jeta e tyre ndryshoi përgjithmonë.

Pas 15 vitesh në pushtet, Pinocheti u përball me një referendum në vitin 1988.

Pyetja ishte e thjeshtë: a duhej të qëndronte ai në pushtet?

Rreth 55% e votuesve kundërshtuan vazhdimin e regjimit.

Ky rezultat hapi rrugën për zgjedhjet demokratike dhe rikthimin e institucioneve civile. Në vitin 1990, Pinocheti ia dorëzoi pushtetin presidentit

të zgjedhur Patricio Aylwin.

Por edhe pas rikthimit të demokracisë, trashëgimia e diktaturës vazhdoi të mbetet një nga çështjet më të diskutueshme të shoqërisë kiliane.

Për disa kiliane, 11 shtatori është dita kur u rrëzua një qeveri që po e çonte vendin drejt një krize ekonomike dhe politike.

Për të tjerë, është dita kur demokracia u shkatërrua dhe nisi një diktaturë 17-vjeçare. Kjo ndarje nuk është zhdukur.

Dhe pikërisht për këtë arsye vendimi i presidentit José Antonio Kast për të mos organizuar këtë vit një ceremoni zyrtare ka shkaktuar kaq shumë reagime.

Këtë vit, për herë të parë që nga rikthimi i demokracisë, qeveria nuk do të zhvillojë një ceremoni zyrtare për përvjetorin e grushtit të shtetit.

Kast do të ndjekë axhendën e tij institucionale dhe do të jetë në rajonin e Los Ríos. Qeveria thotë se vendi duhet të përqendrohet te problemet aktuale dhe të “shikojë përpara”.

Por opozita argumenton se presidenti duhet të kujtojë të gjithë viktimat dhe të gjitha familjet e prekura nga diktatura.

Vendimi është veçanërisht i ndjeshëm edhe për shkak të historisë politike të Kastit. Ai ishte një nga politikanët që votoi “Po” në referendumin e vitit 1988, që do t'i kishte lejuar Pinochetit të qëndronte në pushtet.

Kjo e bën edhe më të fortë debatin rreth mënyrës se si qeveria aktuale e sheh trashëgiminë e 11 shtatorit 1973.

Në Santiago, dita e përvjetorit vazhdon të shoqërohet me protesta dhe masa të forta sigurie. Priten mobilizime në disa zona të kryeqytetit dhe autoritetet janë në gatishmëri për përplasje të mundshme.

Ndërkohë, familjet e viktimave dhe grupet e të drejtave të njeriut vazhdojnë të organizojnë ceremonitë e tyre.

Në këtë mënyrë, 11 shtatori mbetet një datë ku historia, politika dhe kujtesa përplasen ende.

53 vite pas bombardimit të La Monedës, Salvador Allende vazhdon të jetë një figurë simbolike për të majtën kiliane dhe për ata që e shohin si presidentin që u rrëzua nga një grusht shteti.

Augusto Pinocheti mbetet simbol i diktaturës dhe i represionit për viktimat dhe familjet e tyre.

Dhe Kili, edhe sot, vazhdon të përballlet me pyetjen se si duhet kujtuar një nga ditët më të errëta të historisë së tij: duke parë pas, për të mos harruar, apo duke parë përpara, siç kërkon qeveria aktuale.

Por për familjet e mijëra viktimave, e kaluara nuk është thjesht histori. Është ende një pjesë e jetës së tyre.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82



Sayed Mosawi ngre flamurin e Kosovës, shpallet kampion bote në Muaythai

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Garuesi i Muay Thai-t, Sayed Mosawi, është shpallur kampion bote për seniorë në Kampionatin Botëror të IFMA-s, i cili po mbahet në Deçan dhe

organizohet nga Federata e Muaythait të Kosovës. Mosawi, me prejardhje nga Afganistani dhe i rritur në Suedi, tashmë është shtetas i Kosovës dhe përfaqëson Republikën e Kosovës

në arenën ndërkombëtare. Për suksesin e Mosawit ka reaguar edhe Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK), i cili e ka uruar garuesin për triumfin. “Medalje, por të bronzta, fituan edhe

Domenik Nrecaj, Arjan Hajdari dhe Elton Shyti. Urime garuesve dhe Federatës së Muaythait të Kosovës për suksesin e arritur”, ka njoftuar KOK-u.



DUKAGJINI VAZHDON SERINË POZITIVE, MPOSHT MALISHEVËN DHE NGJITET NË VENDIN E DYTË



KLINË, 11 SHTATOR - Dukagjini ka shënuar fitore në përballje me Malishevën në ndeshjen e fundit të javës së pestë të Albi Mall Superligës së Kosovës. Ndeshja, e zhvilluar nën dritën e reflektorëve në stadiumin “18 Qershori” në Klinë, përfundoi me rezultat 2:0 në favor të skuadrës vendase. Dukagjini e ka zhbllokuar rezultatin në minutën e 19, kur

Mërgim Pefqeli ka realizuar një gol të bukur për epërsinë e vendësve. Avantazhin e ka dyfishuar Dient Isufi në minutën e 31-të, duke e çuar rezultatin në 2:0. Malisheva, e cila në fillim të ndeshjes pati disa raste, edhe në pjesën e dytë është përpjekur ta ndryshojë rrjedhën e ndeshjes, por nuk ka arritur ta gjejë rrugën e

golit. Në fund të ndeshjes, Dukagjini ka pasur mundësinë ta thellojë epërsinë, por Altin Merlaku nuk ka arritur ta konkretizojë një rast të pastër. Kjo ishte fitorja e tretë e Dukagjinit në këtë edicion të Albi Mall Superligës. Me këto tri pikë, skuadra e drejtuar nga Armend Dallku ngjitet në vendin e dytë me 11 pikë, një më pak se liderja Prishtina.

NGA STARTI I ËNDRRAVE, TE BETEJA PËR TITULL, ALBIN KRASNIQI FLET PËR AMBICIET E PRISHTINËS

PRISHTINË, 11 SHTATOR - Prishtina e ka nisur në mënyrën më të mirë të mundshme sezonin e ri në Superligën e Kosovës. Katër ndeshje, katër fitore dhe vendi i parë në tabelë kanë rikthyer entuziazmin te klubi kryeqytetas, i cili synon të rikthehet në majat e futbollit vendor. Një prej futbollistëve që ka dhënë kontribut të rëndësishëm në këtë start është Albin Krasniqi, i cili deri tani ka shënuar katër gola. Në një intervistë për “Telegrafin”, Krasniqi ka folur për fillimin e sezonit, formën e tij personale, ndikimin e trajnerit Orges Shehi, rivalët në garën për titull, ambiciet e

skuadrës dhe mbështetjen e madhe të “Plisave”. Krasniqi është i kënaqur me kontributin që është duke dhënë për skuadrën, por ka thënë se më shumë rëndësi ka forma e mirë e ekipit. “Normalisht jam i kënaqur që po e ndihmoj ekipin, por më i kënaqur jam me formën e ekipit që kemi. Shpresoj shumë që të vazhdojmë me këtë formë”, ka thënë Krasniqi. Pavarësisht prej startit perfekt, sulmuesi prishtinas nuk ka dashur të flasë ende për titullin, duke theksuar se fokusi i skuadrës është te ndeshja e radhës. “Kemi nisur kampionatin mjaft mirë.

Objektivi ynë është vetëm ndeshja e radhës, ndërsa llogaritë do t'i bëjmë në fund. Shpresojmë shumë që gjërat të shkojnë mirë deri në fund”, ka thënë ai. Për këtë fillim pozitiv, Krasniqi meritat ia ka atribuuar edhe trajnerit Orges Shehi. “Trajneri ka merita të mëdha. Kemi një atmosferë të mirë brenda klubit dhe të gjithë jemi të etur për sukses. Po mundohemi t'i zbatojmë detyrat e trajnerit në përpikëri dhe të vazhdojmë me paraqitje pozitive”, ka thënë Krasniqi. Sa iu përket objektivave personale, ai ka thënë se synon të vazhdojë ta ndihmojë ekipin,



të Prishtinës. “Kampionati është shumë i fortë. Si rivalë i shoh Dritën, Ballkanin, Malishevën dhe Gjilanin, por më shumë mendojmë për veten sesa për ekipet e tjera”, ka thënë ai. Në fund, Krasniqi kishte një mesazh të veçantë për “Plisat”, të cilët po e mbështesin fuqishëm Prishtinën edhe këtë sezon. “‘Plisat’ janë forca jonë në çdo ndeshje. Nuk ka dallim se ku luajmë, ata janë gjithmonë aty për ne. Mesazhi im për ‘Plisat’ është të vazhdojnë të besojnë te ky grup dhe, me ndihmën e Zotit, në fund të kampionatit të gëzojemi bashkë për sukseset e Prishtinës”, ka thënë Krasniqi.

ELBASAN RASHANI RIKTHEHET NË NORVEGJI, I BASHKOHET VALERENGAS

OSLO, 11 SHTATOR - Sulmuesi i Kombëtares së Kosovës, Elbasan Rashani, është rikthyer në futbollin norvegjez, duke iu bashkuar Valerengas si lojtar i lirë. Pas largimit nga Melbourne City, 33-vjeçari ka vendosur të

rikthehet në futbollin elitare të Norvegjisë, ku Valerenga bëhet skuadra e tretë norvegjeze në karrierën e tij, pas aventurave me Odd dhe Rosenborg. Rashani vitin e kaluar ishte pjesë e Elches në ligën e dytë

spanjolle, ndërsa së fundmi ishte pjesë e Melbourne Cityt në Australi. Me klubin australian, ai bëri 18 paraqitje gjatë sezonit të kaluar. Gjatë karrierës së tij, Rashani ka luajtur edhe në Francë, Turqi,

Danimarkë dhe Spanjë. Rikthimi në Norvegji i jep Rashanit mundësinë për ta vazhduar karrierën në një kampionat që e njeh mirë dhe ku më herët ka lënë gjurmë me paraqitjet e tij.



Real Madridi e “blindon” Gulerin


MADRID, 11 SHTATOR - Real Madridi ka arritur marrëveshje për rinovimin e kontratës me mesfushorin turk Arda Guler. 21-

vjeçari pritet të qëndrojë në Madrid deri në qershor të vitit 2032, ndërsa zyrtarizimi i marrëveshjes pritet së shpejti.

Guler ka fituar besimin e plotë të stafit teknik në skuadrën madrilene. Sezonin e kaluar ai zhvilloi 51 ndeshje, duke shënuar

gjashtë gola dhe duke dhuruar 14 asistime. Në këtë sezon, turku ka regjistruar një gol dhe një asistim në katër paraqitje në La Liga.





N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail..contact@pallatirinese.com
www.pallatirinese.com



Në bazë të dispozitave të nenit 21, pikës 21.4 të Ligjit nr. 03/L- 087 Për Ndërmarrjet Publike, gjegjësisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 17 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me datë 11.09.2026 bazuar mbi Vendimin Nr. 1/2058 publikon këtë:

KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e një (1) pozite

- 1. Titulli i punës:** Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e
Vendi: Prishtinë.
Ndërmarrja: N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve.
Mandati: 3 vite
Koeficienti: 5.9
- 2. Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:**
Bordi i Drejtorëve, dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t’i përmbushë edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale në vijim:

 - Të posedojë diplomë universitare -Fakulteti Juridik (jurist i diplomuar ose master në shkenca juridike);
 - Të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;
 - Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L- -087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 neni 13;
 - Aftësi për punë ekipore;
 - Të ketë aftësi të mira komunikuese;
 - Të ketë etikë në punë dhe integritet.
 - Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
 - Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);
 - Dëshmitë mbi njohuritë dhe të arriturat tjera do të mirren në konsideratë dhe vlerësohen konform relevancës me vendin e punës;
 - Të jetë person me integritet të lartë dhe të plotësoj të gjitha kushtet e përshtatshmërisë të parapara me neni 17 të Ligjit të Ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 , dhe plotësim ndryshimet përkatëse,Ligji për Parandalimin e konfliktit të interes në ushtrimin e funksionit public nr/06L-011, si dhe me normat tjera positive relevante.
- 3. Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e ka këto detyra dhe përgjegjësi:**

 - Sigurohet që të përcillen procedurat e Bordit, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe Aksionarëve duke përfshirë (në bashkëpunim me Kryesuesin) përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave;
 - Mban regjistrin e aksionarëve;
 - Koordinon me KE përgatitjen e materialit për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
 - Mban procesverbalin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesit e tyre) dhe i regjistron në librat e protokolleve;
 - Shpërndan procesverbalet tek drejtorët dhe aksionarët;
 - Merret me regjistrimin zyrtar të ndryshimeve të cilat kërkohen sipas ligjit, i regjistron në regjistrin e Kosovës për shoqëritë tregtare dhe emrat tregtarë;
 - Sipas udhëzimeve nga Kryesuesi, përgjegjësitë e Sekretarit përfshijnë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit dhe komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndërmarrjes;
 - Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve i cili njëheri është përgjegjës tek Bordi për të siguruar që përputhen procedurat e Bordit;
 - Përcjell ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe menaxhmentin e kompanisë për ndryshimet si dhe përgatitë udhëzimet e nevojshme për menaxhmentin e kompanisë.Merret edhe me çështjet tjera të qeverisjes korporative sipas nevojës.

- 4. Informatë për procedurën e konkurimit**

 - Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
 - Formulari i kërkesës për punësim (aplikimit);
 - Kopje e letërnjoftimit; CV ; Çertifikata e lindjes;Letër motivimi;
 - Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin profesional e noterizuar;
 - Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
 - Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
 - Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvoja të punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
 - Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP e cila mundë të shkarkohet nga uebfaqja e Kompanisë;
 - Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
 - Lista e dokumenteve të dorëzuara.
- 5. Afati i Konkursit:**
Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data **11.09.2026 deri më 10.10.2026**
Të interesuarit mund t’i dorëzojnë kërkesat (aplikacionet) e tyre me dokumentet tjera relevante në emailin: burimetnjerezore@pallatirinese.com
Formulari për kërkesë (aplikim) dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga web-faqja e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë
në <http://www.pallatirinese.com/> ose mund të merren në zyret e Ndërmarrjes.

6. Vërejtje:
Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurrimit, do të refuzohen.
Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Rolanda isufi nga Beci i Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të Sh.F.M.U “Ahmet Rrustemi”, nga klasa 1-5 dhe 6-9.

- Vjollca N.Krasniqi B.I nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin UNIK Identifikues të biznesit: 810201773 të lëshuar nga ARBK.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi “ Prizren.

- Trim Reznici shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Sebastjan Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.


- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinese.com
www.pallatirinese.com

Na osnovu odredbi člana 21, tačke 21.4 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i na osnovu člana 17 Statuta, Upravni odbor N.P.L. PALLATI I RINISE AD, od 11.09.2026. godine, na osnovu Odluke Br. 1/2058 objavljuje ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje jedne (1) pozicije

1. Naziv radnog mesta: Generalni savetnik - Sekretar preduzeća
Lokacija: Priština.

Preduzeće: N.P.L. PALLATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini.

Odgovoran: Upravnom odboru.

Mandat: 3 godine

Koeficijent: 5.9

2. Generalni savetnik - Sekretar preduzeća ima sledeće dužnosti i odgovornosti: Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove iz člana 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) nisu, ili u bilo kom trenutku tokom trideset šest (36) meseci pre datuma podnošenja zahteva nisu bili, direktori Upravnog odbora relevantne kompanije i (iv) imaju neophodno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju; Svako lice koje želi da bude razmatrano za poziciju direktora mora takode ispunjavati sledeće uslove stručne podobnosti:

- Posedovati univerzitetsku diplomu - Pravni fakultet (diplomirani pravnik ili master pravnih nauka);

- Posedovati najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti korporativnog upravljanja ili kompanijskog prava;

- Ispunjavati kvalifikacione uslove iz člana 17.1 i ispunjavati kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i izmene ZJP br. 04/L-111, član 13;

- Sposobnost za timski rad;
- Posedovati dobre komunikacijske veštine;
- Posedovati radnu etiku i integritet.
- Posedovati računarske veštine;
- Znanje engleskog jezika (poželjno);
- Dokazi o drugim znanjima i dostignućima biće uzeti u obzir i procenjeni u skladu sa relevantnošću za posao;
- Biti osoba sa visokim integritetom i ispunjavati sve uslove podobnosti utvrđene članom 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 i relevantnim izmenama, Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija br. 06/L-011, kao i drugim relevantnim pozitivnim normama.

3. Generalni savetnik - Sekretar kompanije ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Osigurati da se poštuju procedure Odbora, uključujući organizaciju sastanaka Odbora, odbora Odbora i akcionara, uključujući (u saradnji sa predsednikom) pripremu i distribuciju dnevnog reda;
- Voditi registar akcionara;
- Koordinirati sa Izvršnom komisijom pripremu materijala za sastanke Odbora direktora;
- Voditi zapisnike sa sastanaka Odbora direktora i Odbora za reviziju (osim ako njihovi predsednici ne zahtevaju drugačije) i evidentirati ih u zapisnicima;
- Distribuirati zapisnike direktorima i akcionarima;
- Obavljati zvaničnu registraciju promena koje zahteva zakon, evidentirajući ih u Kosovskom registru trgovačkih društava i trgovačkih imena;
- Prema uputstvima predsednika, odgovornosti Sekretara uključuju obezbeđivanje nesmetanog protoka informacija unutar Odbora i njegovih odbora i između Odbora i višeg menadžmenta Kompanije;
- Saveti i usluge Sekretara biće dostupni svim direktorima i biće odgovoran Odboru za obezbeđivanje usklađenosti sa procedurama Odbora;
- Prati pravne promene koje se odnose na Društvo tako što obaveštava Upravni odbor i rukovodstvo Društva o promenama i priprema neophodna uputstva za rukovodstvo Društva. Takođe se bavi i drugim pitanjima korporativnog upravljanja po potrebi.

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog fonda za penzijsku štednju, i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili u obavezi da plaćaju ovoj instituciji);
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa veb stranice Kompanije;
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak podnetih dokumenata.

5. Rok za konkurs:

Javni konkurs je otvoren u periodu od 30 (trideset) dana od 11.09.2026 do 10.10.2026. Zainteresovana lica mogu podneti svoje prijave sa ostalom relevantnom dokumentacijom na imejl adresu: burimetnjerezore@pallatirinese.com Obrazac za prijavu i izjava pod zakletvom mogu se preuzeti sa veb stranice N.P.L. PALLATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini na <http://www.pallatirinese.com/> ili se mogu dobiti u kancelarijama Kompanije.

6. Napomena:

Kandidati sa nepotpunom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van roka za konkurs biće odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju navedene kriterijume i koji su uvršteni u uži izbor.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ANDI AG-M” Sh.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810236811 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ANDI AG-M” D.O.O. od Gjakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810236811 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “ANDI AG-M” L.L.C. with headquarters Gjakova, has come to the decision to quit its business: 810236811 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: ☐ Furnizim ☒ Shërbimc ☐ Punë

Nr. i Prokurimit 07-26

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën Instituti A, Kati 2, QKUK, 10 000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:

Dosja për: Kontratë për sigurimin e hapësirave dhe shërbimeve për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve të Odës së Mjekëve të Kosovës

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

- ☒ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).
- ☐ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **25.09.2026 ora 14:00.**
Afati i fundit për aplikim në Tender është: **28.09.2026 ora 12:00.**
Hapja e ofertave bëhet me datën: **28.09.2026 ora 12:00.**





TRADITË QË NGA 1992

